



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 366/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjekti politik Partija Kosovskih Serba (PKS), dega në Leposaviq, paraqitur kundër kryesuesve të vendvotimit, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 02.07.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të pasafatshme ankesat Anr.366/2017 Anr 367/2017, të datës 30.06.2017, parashtruara nga subjekti politik Partija Kosovskih Serba (PKS), dega në Leposaviq.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar dy ankesa me datë 30.06.2017, nga subjekti politik Partija Kosovskih Serba (PKS), dega në Leposaviq. Në ankesën Anr 366/2017 pretendon se në vendvotimin 1215B/01D ka pasur parregullsi të shumta ku është votuar në emër të dy personave të vdekur si dhe ankesën Anr.367/2017 në të cilën pretendon se në vendvotimin 1202/02R ka pasur parregullsi ku në ditën e votimit disa persona nga Kragujevci dhe Kraleva kanë votuar pa asnjë dokument valid të Kosovës. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të anulohet rezultatet në këto vendvotime dhe të përsëritet votimi.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 366/2017, për shkak të natyrës së njejtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për ankesën Anr 367/2017, vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërin e ankesës, gjeti se :

**Ankesa është e pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të LZP-së. Në rastet konkrete qendra e votimit është mbyllur më datë 11.06.2017 në ora 19:00, ndërsa ankesa nga ankuesi është parashtruar në PZAP me datë 30.06.2017, që do të thotë pas afatit të paraparë me ligjor të përcaktuar me nenin 119 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 366/2017 më datën 02.07.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Ymer Hoxha



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.